



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Rr "Perlat Rexhepi" Pall 10/1 Tirane, Tel 355 4 247 148 Tel & Fax 4 250 686 www.amf.gov.al

**FORMULAR – KËRKESË**

**PËR**

**PAJISJE ME LICENCË “BROKER NË SIGURIME”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe VKM-së Nr. 79, datë 28.01.2008 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës”, si dhe aktet e tjera, ligjore e nënligjore, paraqes kërkesën si më poshtë:

**1. Veprimtaria e ndërmjetësimit si broker do të ushtrohet në:**

**A. Sigurimin e Jo Jetës**

Sigurim i aksidenteve dhe e shëndetit     Sigurime motorike     Sigurimi i marinës dhe i transportit     Sigurimi i avionëve     Sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë     Sigurimi i përgjegjësive     Sigurimi i kreditit dhe i garancisë

**B. Sigurimin e Jetës**

**2. Licenca kërkohet për ushtrimin e veprimtarisë së brokerit si:**

Person Fizik

Shoqëri Brokerimi

**3. Në rastin e ushtrimit të veprimtarisë si person fizik:**

Emri .....

Atësia .....

Mbiemri .....

Adresa e vendbanimit:

Rruga ....., Qyteti ....., Rrethi .....

Adresa ku do të ushtrohet veprimtaria / selia:

Rruga ....., Qyteti ....., Rrethi .....

Nr. kontakti, Tel ....., Fax .....

**4. Në rastin e ushtrimit të veprimtarisë si person juridik (shoqëri brokerimi):**

Emri i shoqërisë ..... sh.a  
Nr. NIPT-i .....  
Adresa ku do te ushtrohet veprimtaria / selia:  
Rruga ....., Qyteti ....., Rrethi .....  
Nr. kontakti, Tel ....., Fax .....

**5. Brokerat e licensuar në funksionin e brokerit pranë shoqërisë Tuaj janë:**

Persona fizikë                       Ortakë                       Aksionerë

**6. Numri i tyre është :**

Nr .....

**Të dhëna personale të tyre:**

Emri .....	Emri .....
Atësia .....	Atësia .....
Mbiemri .....	Mbiemri .....
Adresa e plotë:	Adresa e plotë:
Rruga .....,	Rruga .....,
Qyteti ....., Rrethi .....	Qyteti ....., Rrethi .....
Nr. kontakti, Tel ....., Fax.....	Nr. kontakti, Tel ....., Fax .....

*(nëse numri i personave që do të ushtrojnë funksionet e brokerit në shoqërinë e brokerimit është më shumë se një, këto të dhëna të jenë në një format tjetër bashkëngjitur kësaj formë kërkesë)*

***Nëpërmjet plotësimit të formular kërkesës dhe dokumentacionit plotësues bashkëngjitur këtij formulari, deklaroj se informacioni i paraqitur është i plotë, i vërtetë, i saktë dhe nuk përmban fshehje të fakteve.***

**Personi Kërkuar:**

\_\_\_\_\_ ( Emër, Mbiemër, Nënshkrim)

**Data** \_\_\_\_\_

***Shënim: Kjo formë kërkesë është e pavlefshme nëse nuk është e shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm.***

**DOKUMENTACIONI SHOQËRUES I FORMATIT TË KËRKESËS SË APLIKIMIT  
PËR LICENSË BROKERI NË SIGURIME DHE RISIGURIME:**

**I. PERSONI FIZIK QË KËRKON TË PAJISSET ME LICENSË BROKERI NË  
SIGURIME DUHET TË PARAQESË:**

1. Kopje të noterizuar të diplomës së shkollës së lartë;
2. Dokument që vërteton përvojën në fushën e sigurimeve ose kualifikime të vërtetuara me certifikatë, në programe të njohura nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
3. Kërkesë me shkrim ku të cilësohet fusha e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, sipas klasave të sigurimit dhe territorin ku do të kryhet kjo veprimtari;
4. Deklaratë personale për datën se kur do të fillojë veprimtaria;
5. Dokumentin që vërteton se ka mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimtari ndërmjetësimi në sigurime dhe risigurime;
6. Dokument identifikimi (certifikatë personale me fotografi e periudhës jo më e vjetër se tre muajt e fundit para aplikimit, pasaportë, letër njoftimi) që vërteton aftësinë për të vepruar;
7. Fotografi personale cope 2;
8. Dokument që vërteton se nuk është dënuar për ndonjë vepër që përbën arsye për refuzim license, si vepra kriminale ndaj pronës, vepra të krimit ekonomik, veprimtari të jashtëligjshme gjatë 10 vjetëve të fundit para datës së kërkesës për licensë;
9. Dokument që vërteton se s'ka detyrime të pashlyera në afat (vërtetim nga organet tatimore dhe nga regjistri i kredive pranë Bankës së Shqipërisë);
10. Deklaratë personale që vërteton se nuk është i punësuar në ndonjë shoqëri sigurimi;
11. Deklaratë personale që vërteton se nuk ka qenë anëtar i këshillave mbikëqyrëse apo drejtues i shoqërive në proces falimentimi a likuidimi, gjatë 5 viteve të fundit;

**II. PERSONI JURIDIK QË KËRKON TË PAJISSET ME LICENSË BROKERI NË  
SIGURIME DUHET TË PARAQESË:**

1. Dokumentin e regjistrimit si shoqëri anonime me seli qendrore në RSH, akt themelimi dhe statutin e shoqërisë;
2. Dokumentin që vërteton zotërimin e kapitalit minimal të shoqërisë së brokerimit prej 5 milionë Lekë;
3. Dokumentin që vërteton se ka mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimtari ndërmjetësimi në sigurime dhe risigurime;

4. Kërkesë me shkrim ku të cilësohet fusha e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, sipas klasave të sigurimit dhe territori ku do të kryhet kjo veprimtari;
5. Deklaratë e Drejtorit të Përgjithshëm për datën se kur do të fillojë veprimtaria;
6. Dokument që vërteton sigurimin në një shoqëri sigurimi të përgjegjësive profesionale ndaj palëve të treta, për shkak të shkeljes së kushteve të kontratës së ndërmjetësimit, në një shumë jo më të vogël se 30 milionë Lekë për një rast sigurimi ose jo më të vogël se 100 milione Lekë për të gjitha rastet e sigurimit në një vit kalendarik;
7. Dokumentin që vërteton se s'ka detyrime të papaguara në afat (vërtetim nga organet tatimore dhe nga regjistri i kredive pranë Bankës së Shqipërisë);
8. Dokumentin që vërteton se ka të punësuar, të paktën, një broker të licensuar nga AMF-ja (kontrata midis tyre);
9. Drejtori i Përgjithshëm dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të plotësojnë kërkesat sipas pikës I (të sille dokumentacioni sipas pikës I për këta persona).

**III. DEGA E SHOQËRISË SË HUAJ TË NDËRMJETËSIMIT QË KËRKON TË PAJISËT ME LICENCË BROKERI NË SIGURIME DUHET TË PARAQESË:**

1. Dokumentin e regjistrimit të degës së shoqërisë së huaj të sigurimit si shoqëri anonime me seli qendrore në RSH, akt themelimi dhe statutin e shoqërisë;
2. Dokumenti mbi miratimin zyrtar për hapjen e kësaj dege dhënë nga autoriteti mbikëqyrës i vendit të origjinës;
3. Dokumentacioni sipas pikës II të këtij formulari.